



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në bazë të nenit 95 par.1.2 dhe nenit 151 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Këshilli Drejtues i OAK-së, në mbledhjen e mbajtur më 16.12.2023, nxjerr vendim përmes së cilit:

**NDRYSHOHET RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E  
KOMITETEVE**

**Neni 1**

Neni 7 i Rregullores bazike, ndryshohet si në vijim:

1. Këshilli Drejtues zgjedh anëtarët e Komiteteve, sipas propozimit të secilës Kryesi të Degëve Regjionale si dhe të vet propozuarve. Të propozuarit nuk mund të mbajnë pozita të tjera në OAK.
2. Në Komitete do të zgjedhën nga një anëtarë nga secila degë, deri sa anëtarët e tjerë të Komiteteve zgjedhën sipas parimit të proporcionalitetit sipas numrit të anëtarëve të degëve.
3. Anëtarët e Komiteteve zgjedhën me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues.
4. Kryetari i Komitetit drejton aktivitetin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Komitetit.
5. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet i udhëheqë nënkryetari i tij.

**Neni 2**

Këto ndryshim/plotësime të Rregullores për Organizimin dhe Punën e Komiteteve, hynë në fuqi dhe fillon të zbatohet nga data 16.12.2023.

**Av. Behar Ejupi,  
Kryetar i OAK-së**